



REPUBLIKA E KOSOVËS – ZYRA E PRESIDENTIT
REPUBLIC OF KOSOVO – OFFICE OF THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVA – URED PREDSEDNIKA

KËSHILLI KOMBËTAR PËR INTEGRIM EVROPIAN

Shtojca 1

Rekomandimet e takimit të tretë **12 dhjetor 2012, Prishtinë**

1. Ministria e Integrimit Evropian dhe dikasteret qeveritare të ndërmarrin të gjithë hapat bashkërendues me institucionet përgjegjëse, me qëllim të përmbushjes së të gjitha kriterëve të mbetura afatshkurta të Studimit të Fizibilitetit, dhe planit të veprimit për negociimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit të Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian.
2. Të vazhdohet me intensifikimin e takimeve të përbashkëta të liderëve politikë në lidhje me reformën zgjedhore, mbështetur nga bashkësia ndërkombëtare, dhe kjo të përfundohet me sukses.
3. Të fuqizohen kapacitetet humane, teknike dhe financiare të institucioneve vendore për zbatimin e sundimit të ligjit.
4. Të vazhdohet me intensitet të shtuar reforma e administratës publike me theks në krijimin e një administrate publike transparente, efikase dhe bazuar në parimin e meritës.